



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 533 prot.

Tiranë, më 12.042026

**Lënda:** Njoftim për zhvillimin e takimit konsultativ të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, në kuadër të fazës strategjike të përgatitjes së PBA-së

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 26 të tij; Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, të Ministrisë së Financave, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”; si dhe pikës 8 të Udhëzimit Vjetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029, nr. 6, **datë 27.02.2026**, Ju njoftojmë se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, më datë **27.04.2026, ora 15:00** do të zhvillojë pranë ambienteve të institucionit një **takim konsultativ** me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, në funksion të fazës së parë të hartimit të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029.

Ftohen të marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë, institucione publike dhe aktorë të tjerë të interesit.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të shoqërisë civile konsiderohet me rëndësi të veçantë për garantimin e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe rritjes së efektivitetit të procesit të planifikimit buxhetor të institucionit. Draft-dokumenti i PBA-së do të vihet në dispozicion, sipas kërkesës suaj, përmes adresës zyrtare të e-mailit: **info@kmshe.al**.

Në pritje të bashkëpunimit Tuaj konstruktiv,

